



РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА
REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT

Бр./Nr _____

_____г./в.



Në bazë të nenit 22 paragrafi 1 të Ligjit për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 12/19), neni 40 paragrafi 3 i Rregullores së punës së Komisionit Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit, duke vepruar sipas lëndës së formuar me vetiniciativë, Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit (në tekstin e mëtejme KSHPK), në seancën e 78-të të mbajtur më 14.11.2022 miratoi

VENDIM

Procedura për lëndën me numër 12-7275/1 prej datës 23.12.2021, NDËRPRITET.
KSHPK vërtetoi se lënda nuk ka elemente për veprimin e saj kompetent në pajtim me Ligjin për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesit.

Lënda me numër 12-7275 të vitit 2021 të mbyllet dhe të arkivohet.

Vendimi i KSHPK-së, në formë të depersonalizuar, të publikohet në ueb - faqen e KSHPK-së brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e vendimmarrjes.

Arsyetim

Lënda me numër 12-7275/1 datë 23.12.2021 është formuar me vetiniciativë të KSHPK-së dhe pasi është dëgjuar zëri në lidhje me pretendimet se disa /// ushtronin aktivitetin e tyre në territorin e ///, pa pasur leje pune, d.m.th në kundërshtim me dispozitat e Ligjit për veprimtari hoteliere ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" Nr. 62/04 ... 71/16 dhe "Gazeta Zyrtare e RMV" Nr. 31/20).

Duke vepruar sipas lëndës KSHPK-ja iu drejtua me kërkesë Inspektoratit Shtetëror të Tregut për veprim kompetent dhe mbledhje të të dhënave, informacioneve dhe dokumentacionit. Nga përgjigja e marrë rezulton se Inspektorati Shtetëror i Tregut nuk disponon të dhëna dhe informacione të tilla, pra se gjatë kontrolleve të rregullta nuk janë identifikuar të tilla /// në ///.

Nga e theksuara sa më sipër, KSHPK-ja vlerësoi se nuk ka juridiksion për të vepruar në përputhje me LPKKI dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Dorëzuar deri:
Arkivi i KSHPK -së

Përgaditi: Mr D. D.
Miratoi K. N.

KOMISIONI SHTETËRORË
PËR PARANDALIMIN E KORRUPSIONIT
KRYETARE,
Biljana Ivanovska

